

Më
Dana

13 - 07 - 2017

P.nr.1299/2017

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL, gjyqtari Adem Shabani, me zyrtaren ligjore Lavdije Brahimi, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED] nga fshati [REDACTED], komuna Shtime, i akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.834-1/17 të dt 23.05.2017, sipas së cilës e ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par 1 të KPRK-së duke vendosur rreth kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, më dt.07.06.2017 solli:

AKT GJYKIM

APROVOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.834-1/17 të dt 23.05.2017 dhe gjykata jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari [REDACTED] nga fshati [REDACTED], komuna Shtime, i lindur me datë, [REDACTED] nga i ati [REDACTED] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me dt. 14.05.2017 rrethë orës 12:15, në pyllin-vendin e quajtur "Vorret e Krushkve" rajoni ekonomiko-pyjor "Neredime-Jezerc", me të cilin qeveris Drejtoria për Bujqësi, Pylltari-Sektori i Pylltaris Ferizaj, i pandehuri me qëllim për të vjedhur, ka prerë 3 lisa trungje-dru, të llojit ahu, me dimensione të gjatë boniteti III, me diametër 40-46 cm, me vëllim të përgjithshëm prej 3.69 metra kub, me çrast të dëmtuarës i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 498.15 Euro,-

- me të cilën kreu veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par 1 të KPK-së

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 43, 46 dhe 73 të KPK-së dhe neneve 365 e 495 të KPPK-së i shqipton

DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarin [REDAKTUAR], i shqiptoi dënimin në shumën prej 200 € (dyqind Euro), të cilën shumë i akuzuari obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti do t'i shndërrohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet nga një (1) ditë burg.

Obligohet i akuzuari që të dëmtuarës; Drejtoria për Bujqësi, Pylltari-Sektori i Pylltaris Ferizaj, t'ja kompenzoj dëmin e shkaktuar në vlerë prej 498.15 Euro në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.834-1/17 të dt 23.05.2017 ka akuzuar [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] komuna Shtime, për veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par par 1 të KPK-së dhe të njëjtën ditë ka parashtruar kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor kundër të akuzuarit me arsyen se ka prova të besueshme që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i njëjti.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 parag.1, 2 dhe 3 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor.

Gjyakta duke i shikuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lendes procesverbalin dhe fletëparaqitjen e rojës së pyllit dhe vlerësimin dhe llogarinë e dëmit të shkaktuar, np 234/2017 i dt 16.05.2017 i DBP- Ferizaj, gjykata e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konformë nenit 463 paragrafi 1 lidhur me paragrafi 3 të KPPK-së që të dëmtuaries: Drejtoria për Bujqësi, Pylltari-Spektori i Pylltaris Ferizaj, t'ja kompenzoj dëmin e shkaktuar në vlerë prej 498.15 Euro në afat prej 15 dite pas plotfuqishmerisë të këtij aktgjykimi..

Konformë nenit 450 paragrafi 2.6 të KPPK-së obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ


P.nr.1299/2017 i dt.07.06.2017

Zyrtare Ligjore

Lavdije Brahim

Gjyqtari

Adem Shabani



UDHËZIM JURIDIK:

Kudër këtij aktgjykimi lejohet kundërshtimi në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të dërgesës së njëjtë, gjyqtarit të vetëm gjykues të kësaj gjykate, përmes kësaj gjykate. Pas skadimit të afatit të lejuar për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor bëhet i plotfuqishëm dhe ekzekutohet dënimi i shqiptuar.